1. Qëllimi

Ky dokument përshkruan politikën e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) në lidhje me kushtet dhe rregullat për:

- përdorimin e logos së DPA-së,

- përdorimin e logos së EA, ILAC dhe IAF

-referencën në statusin e MLA nga DPA

-përdorimin e simbolit të akreditimit dhe referencës në akreditim si tekst,

-mbrojtjen e simboleve të akreditimit nga keqpërdorimi,

-përdorimin e markave të EA MLA, ILAC MRA dhe IAF MLA si dhe dhe referenca tek statusi i DPA.

2. Referenca

ISO/IEC 17011:2017 paragrafi 4.3 "Përdorimi i simboleve dhe referencave të tjera të akreditimit.

DA-PO-002, Politika e Akreditimit

EA-1/19:2022 Rregullat për përdorimin e Logos së EA dhe Specifikimet grafike.

ILAC R4:10/2016 Përdorimi i logos së ILAC dhe Tagline

IAF PL 8:2023 Rregullat për përdorimin e logos së ILAC

EA 3/01 S1 M:2025 "Suplementi 1 e EA 3/01 "Rregullat mbi përdorimin e markës EA MLA.

IAF Rezolutat 2015-14, 2016-17 dhe 2018-13.

IAF Rezolutat 2019 -15

IAF Rezolutat 2024-19

3. Logo e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit

Logo e DPA-së është e rregjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave. Të drejtat e kopjimit dhe përdorimit të kësaj logoje i perkasin vetëm Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Logo e DPA-së mund të përdoret vetëm nga DPA dhe personeli i saj (i brendshëm dhe i jashtëm). DPA përdor logon e saj në të gjithë dokumentacionin e sistemit të menaxhimit, materialet e promovimit, mediat e komunikimit si dhe në shkresat e lëshuara prej saj. Personeli i brendshem i DPA-së përdor logon në kartvizitat e tyre ku paraqesin pozicionin në DPA, dhe vetëm për aktivitetet e kryera për DPA. Kryevlerësuesit, vlerësuesit teknikë dhe ekspertët e DPA-së, anëtarët e grupeve teknike të punës, anëtarët e bordit të akreditimit mund të përdorin logon vetëm në dokumentet e DPA-së që ato plotësojnë për vlerësimin e organeve të vlerësimit të konformitetit (OVK) ose cdo veprimtari tjetër që ka lidhje me DPA.

Madhësia dhe ngjyrat origjinale (gri, e zezë, e bardhë dhe e kuqe) janë ato të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave. Madhësia e logos është 25x15 mm. Ngjyrat janë:

	Pantone
Gri	Cool Grey 4; Cool Gray 11
E zezë	Black 6 2X
E bardhë	Bright white
E kuqe	PMS 186
	Pantone

DPA mund të përdorë logon e saj në madhësi të tjera në varësi nga dokumenti, por gjithmonë gërmat duhet të jenë të lexueshme. Është e preferueshme të përdoret në ngjyrat origjinale, por në dokumentet e lëshuara nga DPA logoja mund të përdoret në versionin bardhë e zi.

Organet e vlerësimit të konformitetit (OVK) të akredituara nuk lejohen të përdorin logon e DPA.

4. Përdorimi i logos EA, ILAC, dhe IAF nga DPA.

DPA mund të përdorë logon e EA vetëm pas miratimit të EA. Logoja e EA do të përdoret në kombinim me logon e DPA-së. DPA mund të përdorë logon e EA vetëm për promovimin specifik të EA. Në rastet kur DPA-ja përdor logon e EA-së, duhet të specifikohet kategoria e antarësimit të saj në EA.

Në të gjitha rastet kur do të përdoret logoja e EA, DPA do të marrë të gjitha masat për të shmangur dëmtimin ose zvogëluar reputacionin e EA, keqpërdorimin dhe riprodhimin kundër rregullave të EA.

DPA mund të përdorë logon e ILAC vetëm pas miratimit nga ILAC. DPA mund të përdorë logon ILAC vetëm për promovim specifik të ILAC. Kur e bën këtë, DPA-ja duhet të shfaqë logon e DPA-së së bashku me logon e ILAC. DPA nuk duhet të përdorë vetëm logon e ILAC. Kur DPA-ja shfaq logon e ILAC, ajo duhet të tregojë kategorinë e anëtarësisë së cilës i përket DPA-ja.

Kur logoja ILAC përdoret në një dokument të përkthyer nga anglishtja në gjuhën shqipe, dokumenti duhet të përmbajë një deklaratë për të pranuar se versioni në anglisht i dokumentit do të jetë versioni përfundimtar.

Në të gjitha rastet kur do të përdoret logoja e ILAC, DPA do të marrë të gjitha masat për të shmangur dëmtimin ose për të zvogëluar reputacionin e ILAC, keqpërdorimin dhe riprodhimin kundër rregullave të ILAC.

DPA mund të përdorë logon e IAF vetëm pas miratimit nga IAF. DPA mund të përdorë logon e IAF vetëm për promovimin specifik të IAF. Kur e bën këtë, DPA duhet të shfaqë logon e DPA së bashku me logon IAF. DPA nuk duhet përdorë vetëm logon e IAF. Aty ku DPA shfaq logon e IAF, ajo duhet të tregojë kategorinë e anëtarësimit të cilës i përket DPA.

Kur logoja e IAF përdoret në një dokument të IAF të përkthyer nga anglishtja në gjuhën shqipe, dokumenti duhet të përmbajë një deklaratë për të pranuar se versioni në anglisht i dokumentit do të jetë versioni përfundimtar.

Në të gjitha rastet kur do të përdoret logoja e IAF, DPA do të marrë të gjitha masat për të shmangur dëmtimin ose për të zvogëluar reputacionin e IAF, keqpërdorimin dhe riprodhimin kundër rregullave të IAF.

Leja e marrë nga DPA për përdorimin e logos EA, ILAC ose IAF nuk e lejon DPA, që ta transferojë atë tek palët e treta. Logoja e EA, ILAC dhe IAF nuk do të përdoret gjithashtu nga stafi i DPA-së. Pezullimi ose përfundimi i anëtarësimit të DPA në këto organizata revokon përdorimin e logove të tyre.

5. Referenca për statusin e MLA nga DPA

DPA është nënshkruese e marrëveshjeve shumëpalëshe të Bashkëpunimit Evropian për Akreditimin (EA) për testimin (ISO / IEC 17025), inspektimin (ISO / IEC 17020), çertifikimin e personave (ISO / IEC 17024) dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit (ISO 17021-1).

DPA është nënshkruese e marrëveshjeve shumëpalëshe të Forumit Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF) për çertifikimin e veprimtarive të sistemit të menaxhimit (ISO 22000, ISO

9001, ISO 14001, ISO / IEC 27001, ISO 13485, ISO 50001,ISO 45001 dhe ISO 37001) dhe për certifikimin e personave.

DPA është nënshkruese e marrëveshjes shumëpalëshe të Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Akreditimit të Laboratorëve (ILAC) për aktivitetet e testimit (ISO / IEC 17025) dhe inspektimit (ISO / IEC 17020).

DPA përdor deklaratën e mëposhtme në certifikatat e akreditimit të lëshuara prej saj për aktivitetet në të cilat DPA është anëtare nënshkruese:

"DPA është nënshkruese e EA MLA ose ILAC MRA ose IAF MLA për aktivitetin përkatës".

Aktivitetet përkatëse janë: testimi, inspektimi, çertifikimi i personave dhe çertifikimi i sistemeve të menaxhimit ".

DPA mund t'i referohet statusit të saj të MLA në shkresa, vërtetime për punë, reklama ose faqe webi për aktivitetet për të cilat DPA është anëtare nënshkruese e MLA. DPA përdor fjalinë e mëposhtme "DPA është anëtare nënshkruese e EA-MLA ose ILAC MRA ose IAF MLA për aktivitetin përkatës".

DPA mund të përdorë markën IAF MLA, markën ILAC MRA dhe markën EA MLA vetëm në kombinim me logon e saj. Logoja e kombinuar do të përdoret në bashkëpunim me fushat kryesore të EA MLA, ILAC MRA dhe IAF MLA dhe / ose nënshkruese, në rastin e IAF MLA, për të cilën DPA është nënshkruese e aktiviteteve të MLA. Logoja e kombinuar mund të përdoret në çertifikatat e akreditimit, shkresa, vërtetime për punë, media sociale, reklama ose faqe webi. Përdorimi i markave ILAC MRA dhe IAF MLA mund të bëhet vetëm pasi licenca të miratohet nga ILAC ose IAF.

Përdorimi i markës EA MLA nga DPA do të bëhet vetëm pas marrjes së miratimit nga sekretariati i EA. Përdorimi i markës EA MLA në certifikatat e akreditimit, media sociale dhe website nuk duhet të krijojë konfuzion në lidhje me lëshuesin e dokumentit.

Markat EA MLA, ILAC MRA dhe IAF MLA nuk përdoren në kartvizitat e stafit të DPA-së.

6. Simboli i akreditimit dhe referenca si tekst në akreditim

Simboli i akreditimit përmban logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, veprimtarinë e vleresimit te konformitetit, standardin kundrejt të cilit është akredituar dhe numrin e akreditimit. Numri i akreditimit është numri i certifikatës së akreditimit dhe përbëhet nga shkurtimi i vlerësimit të konformitetit dhe numri rendor.

Menyra e paraqitjes së simboleve të akreditimit per secilën veprimtari të vlerësimit të konformitetit jepet në paragrafin 10 të kësaj politike.

DPA pajis çdo OVK të akredituar me simbolin e vet të akreditimit në një CD. Në simbolin e akreditimit madhësia e logos së DPA është 25x15 mm dhe është në ngjyrat origjinale, ndërsa veprimtaria, standardi dhe numri i akreditimit shkruhen sipas rendit të dhënë dhe me "Times New Roman" me madhësi 11 dhe me ngjyrë të zezë. Ndërmjet veprimtarisë, standardit dhe numrit të akreditimit nuk vendoset hapësirë bosh.

Dimensionet e jashtme të simbolit të akreditimit, kur kjo përdoret në dokumente të madhësisë A4, nuk lejohen të jenë më të mëdha se 25x33 mm dhe ne rastin e simboleve te kombinuar do te jenë 25x50mm. Në dokumentet me dimensione më të vogla ose të mëdha, dimensionet e simboleve do të jenë proporcionalisht më të vogla ose më të mëdha, por simboli i akreditimit nuk mund të jetë më i madh se logoja e OVK-së të akredituar.

Simboli i akreditimit, i kombinuar ose jo me markat EA MLA, ILAC MRA ose IAF MLA, duhet të vendoset në pjesën e sipërme të raportit / certifikatës në anën e djathtë, ndërkohë që logo e OVK vendoset në pjesën e sipërme të raportit / certifikatës në anën e majtë.

Në çdo material tjetër promovues dhe mjete të komunikimit masiv, simboli i akreditimit do të ketë dimensionet përkatëse si më sipër, por duhet të mbulojë maksimumi 1/100 e sipërfaqes totale.

Në raportet / çertifikatat e lëshuara nga OVK, simboli i akreditimit mund të jetë bardh e zi me kushtin që të mbahet kërkesa për madhësinë dhe pozicionin.

Në materialet promovuese, simboli i akreditimit i kombinuar me logon e OVK, mund të jetë bardhë e zi, me kushtin e që logo e OVK të jetë gjithashtu bardhë e zi. Në faqen e webit dhe mediat elektronike, simboli i akreditimit duhet të jetë gjithmonë me ngjyrat e tij origjinale.

Pavarësisht se ku përdoret, simboli i akreditimit nuk mund të deformohet apo të rrotullohet. Nuk mund të shfaqet në madhësi apo në sfond që e bën logon e DPA, veprimtarinë, standardin dhe numrin e akreditimit të palexueshëm. Simboli i akreditimit nuk duhet të jetë i fshehur ose i mbivendosur plotësisht ose pjesërisht nga ndonjë imazh, tekst ose imazh grafik tjetër.

Referenca në akreditim si tekst duhet të shkruhet në të njëjtën madhësi të shkronjave si artikujt e tjerë të përfshirë në dokument. Referenca si tekst do të jetë në të njëjtat ngjyra me artikujt e tjerë të përfshirë në dokument. Referenca si tekst në raportet/certifikatat e lëshuara nga OVK e akredituara do të vendoset në pjesën fundore të dokumentit dhe e pozicionuar në mes të formatit A4. Referenca si tekst nuk mund të jetë e fshehur apo të mbulohet plotësisht apo pjesërisht nga ndonjë imazh apo tekst tjetër.

7. Përdorimi i simbolit të akreditimit nga OVK-të e akredituara nga DPA

Referenca për statusin e akredituar mund të bëhet duke përdorur simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst. OVK e akredituar nuk mund të përdorë simbolin e akreditimit dhe referencën në akreditim si tekst në të njëjtin dokument.

Organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA janë të detyruar të përdorin simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst në raporte / çertifikata në mënyrë që të provojnë njohjen e kompetencës së tyre tek një palë e tretë, ose kur raportet / certifikatat që përmbajnë rezultate të mbuluara nga programi i akreditimit janë në zonën ku akreditimi është i detyrueshëm me ligj ose në kushtet e kontratës (psh. sipas një skeme të vlerësimit të konformtietit) ose kur ato i paraqiten ose dërgohen palëve të treta (publik ose autoritete), nëse kjo nuk ndalohet sipas kërkesave ligjore ose të rregullatorëve.

Kur klienti i një OVK kërkon një aktivitet, i cili mbulohet nga programi i akreditimit të OVK, pritshmëria e klientit është që të marrë një raport/certifikatë të akredituar. Për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit që mbulohen nga programi i akreditimit të OVK, OVK-ja duhet të lëshojë një raport /certifikatë të akredituar, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord paraprakisht në mënyrë eksplicite në një marrëveshje ligjore ose të dokumentuar midis OVK -së dhe klientit të saj. Në këto raste, OVK -ja duhet të informojë klientin e saj se raportet / certifikatat e tilla nuk janë raporte / certifikata të akredituara dhe si pasojë nuk mbulohen nga EA MLA-ja.

Bazuar në rregullat e Organizatës Evropiane të Akreditimit (EA 3/01), përputhshmëria me standardin përkatës të akreditimit nuk prezumohet dhe aktiviteti nuk do të njihet si një aktivitet i akredituar, rrjedhimisht edhe i pa mbuluar nga EA MLA nëse, rezultatet lëshohen pa simbolin e akreditimit ose pa referencën në akreditim si tekst nga një OVK e akredituar.

Organet certifikuese të akredituara nga DPA-ja (të sistemeve të menaxhimit, të personave dhe produkteve) janë të detyruar të lëshojnë certifikata të akredituara nëse certifikimi është kryer në përputhje të plotë me programin e akreditimit të tyre. Organet certifikuese do të lëshojnë dy dokumente të deklaratës së konformitetit kur fusha e zbatimit i referohet njëkohësisht proceseve të mbuluara dhe jo të mbuluara nga akreditimi.

Laboratorët testues dhe mjekësorë të akreditуar nga DPA janë të detyruar të përdorin simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst në të gjitha raportet/certifikatat në të cilat të paktën një test është i akreditуar. Në raportet/certtifikatat e lëshuara nga laboratorë të akreditуar ku përfshihen rezultate edhe të testeve të akredituara edhe të testeve të paakredituara, laboratori duhet të përdorë një mënyrë identifikimi për të dalluar se cilat janë testet e akredituara dhe cilat janë të paakredituara duke përdorur shënimin me yll (*). Në fund të raportit/certifikatës të testimit do të jetë gjithmonë shënimi: Yll (*) tregon që testi është i akreditуar/i paakreditуar nga DPA. Shënimi duhet të jetë me të njëjtën madhësi shkrimi dhe ngjyre si teksti që është shkruar dokumenti. Në raportet/certifikatat ku të gjitha testet janë të akredituara, nuk është e nevojshme përdorimi i ndonjë identifikimi. Në të tilla raste laboratori mund të përdorë në fund të raportit/certifikatës shënimin: “Të gjitha testet e dhëna më sipër janë të akredituara nga DPA”.

Laboratorët kalibrues të akreditуar nga DPA janë të detyruar të përdorin simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst në cdo certifikatë kalibrimi e cila përmban rezultatet e

kalibrimeve të kryera në përputhje të plotë meprogramin e akreditimit të laboratorit (objekti i kalibruar, fusha e kalibrimit, teknika e kalibrimit, standardi dhe pasiguria në matje).

Organet inspektuese të akreditуar nga DPA janë të të detyruar të përdorin simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst në cdo certifikatë/raport inspektimi ku inspektimet kryhen në përputhje të plotë me programin e akreditimit të organit inspektues (materiali që inspektohet, tipi i inspektimit, standardi i inspektimit).

Organet që kryejnë verifikimin dhe vlefshmërinë si veprimtari të vlerësimit të konformitetit dhe biobankat janë të detyruar të përdorin simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst në cdo certifikatë/raport ku vlerësimi i konformitetit kryhet në përputhje të plotë me programin e akreditimit të organit të vlerësimit të konformitetit.

Organet e akredituara nga DPA duhet të përcaktojnë në manualin e cilësisë ose në dokumenta të tjera të sistemit të menaxhimit modalitetet për përdorimin e simbolit të akreditimit, referencës në akreditim si tekst, përdorimit të markave të EA MLA, ILAC MRA, IAF MLA në raporte/certifikata ose dokumenta apo rastet e tjera kur lejohet sipas kësaj politike.

Simboli i akreditimit ose referenca në akreditim si tekst do të përdoret nga një OVK e akredituar vetëm nën emrin ose emrin e regjistruar tregtar të personit juridik në të cilin ajo mban akreditimin. OVK-të e akredituara mund të përdorin simbolin e akreditimit ose referencën si tekst për aq kohë sa është i vlefshëm akreditimi.

Simboli i akreditimit ose referenca në akreditim si tekst të vendosur në raportet/certifikatat e lëshuar nga organet e akredituara nga DPA nuk do të thotë që DPA mban përgjegjësi për vërtetësinë e rezultateve të vlerësimit të konformitetit ose për opinionet apo interpretimet e derivuara nga këto rezultate të mbuluara nga akreditimi.

Simboli i akreditimit ose referenca në akreditim si tekst nuk mund të vendoset më vete ose të përdoret për të nënkuptuar që një produkt, proces ose shërbim (ose ndonjë pjesë e tij) është certifikuar ose aprovuar nga DPA.

Simboli i akreditimit ose referenca në akreditim si tekst vendoset në raportet / certifikatat e lëshuara nga OVK-të e akredituara kur ato nënshkruhen nga persona të autorizuar të OVK-së të akredituar.

Simboli i akreditimit ose referenca në akreditim si tekst mund të vendoset gjithashtu në:

- Materialet promovuese dhe mediat e komunikimit të cilat promovojnë aktivitete të akredituara si fletëpalosje, broshura, literaturë teknike, raporte biznesi në përputhje me kërkesat e përshkruara në paragrafin 6
- Faqet e web-it të OVK-ve vetëm për aktivitetet e tyre të akredituara dhe gjithmonë në përputhje me kërkesat e përshkruara në paragrafin 6.

Simboli i akreditimit ose referenca në akreditim nuk mund të përdoret nga:

- Aplikantët për akreditim
- Nënkontraktorët e OVK-ve të akredituara
- Klientët e OVK-ve të akredituara
- Filiale ose kompani simotra të OVK-ve të akredituara
- Ofruesit e shërbimeve të jashtme të një OVK-je që nuk janë të akredituar
- Pronarët e skemave

Simboli i akreditimit ose referenca për akreditim nuk mund të vendosen

- Mbi produktet ose artikujt të cilët janë testuar, kalibruar, çertifikuar ose inspektuar nga një OVK e akredituar.
- Në kartëvizitën e personelit, në automjete, ndërtesa ose flamuj të OVK-ve të akredituara.
- Në materialet promovuese dhe mediat e komunikimit që promovojnë vlerësimin e konformitetit ose aktivitete të tjera që nuk janë të akredituara.
- Në letrat shoqëruese në përgjithësi dhe letrat shoqëruese të raporteve ose çertifikatat që përmbajnë rezultatet e testeve, kalibrimeve, çertifikimeve ose inspektimeve
- Në raportet ose çertifikatat që përmbajnë rezultatet e testit, kalibrimit, çertifikimit ose inspektimit për të cilat akreditimi është pezulluar për aq sa është i vlefshëm pezullimi.
- Në raportet ose çertifikatat që përmbajnë rezultatet e provës, kalibrimit, çertifikimit ose inspektimit kur është tërhequr akreditimi.
- Në raportet e tjera të hartuara nga organet e vlerësimit të konformitetit (p.sh. raporti mjedisor, raporti i vetëvlerësimit për ndikimin në mjedis, etj)
- Në zarfe postare, në kontrata me klientët, në emaile, etj
- Në letrat/dokumentat e dorëzuara në DPA

Në zbatim të kërkesave të standardit ISO/IEC 17025, pika 7.8.7, DPA lejon përfshirjen e shprehjeve të opinioneve dhe interpretimeve në raporte ose certifikata me simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst, nëse laboratori është i akredituar për opinione dhe interpretime dhe nëse ato bazohen në testime/kalibrime të akredituara. Opinioni / interpretimi dhe deklaratat e tjera të pa akredituara duhet të vendosen gjithashtu në një raport të veçantë.

Nëse një OVK e akredituar operon në disa vende, ndër të cilat një nuk është në programin e akreditimit, OVK mund të përdorë simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst vetëm për aktivitetet e kryera në vendin(et) që është përfshirë në programin e akreditimit.

Simboli i akreditimit vendoset vetëm njëherë për cdo faqe të raportit/certifikatës së lëshuar në OVK e akredituar, nëse raporti/certikata përmban rezultatet e aktiviteteve të kryera brenda programit të akreditimit. Në materialet promovuese dhe mediat e komunikimit, simboli i akreditimit vendoset njëherë për cdo material promovues/media, kur bëhet referencë tek akreditimi.

Kur është e mundshme, laboratorët kalibrues mund të përfshijnë simbolin e akreditimit në etiketat e kalibrimit të cilat vendosen në instrumentat e kalibruar. Laboratorët kalibrues mund të përfshijnë simbolin e akreditimit në etiketat e kalibrimit vetëm kur kalibrimi është kryer në përputhje me programin e akreditimit. Prezenca e etiketës së kalibrimit që mban simbolin e akreditimit nuk nënkupton që DPA ka miratuar apo kalibruar pajisjen. Etiketa e kalibrimit duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- Emri i laboratorit kalibrues të akredituar dhe numri i tij i akreditimit
- Identifikimi i pajisjes
- Data e kalibrimit aktual
- Referencën me certifikatën e kalibrimit të lëshuar kundrej kalibrimit.
-

Kur është e mundshme, organi inspektues mund të përfshijë simbolin e akreditimit në etiketat e inspektimit të cilat vendosen në materialin përkatës që është inspektuar. Organet inspektues mund të vendosin simbolin e akreditimit në etiketën e inspektimit vetëm nëse aktiviteti/shërbimi inspektues kryhet në përputhje me programin e akreditimit. Etiketat e inspektimit që mbajnë simbolin e akreditimit nuk duhet të japin përshtypjen apo të nënkuptojnë që DPA ka miratuar apo inspektuar materialin. Etiketa e inspektimit duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- Emri dhe numri i akreditimit të organit inspektues sipas shënimit “materiali është inspektuar nga …….., i akredituar nga DPA me numër akreditimi TI XXX
- Identifikimi i materialit që është inspektuar
- Data e inspektimit
- Referenca me raportin e inspektimit i lëshuar kundrejt inspektimit.

Kur OVK është akredituar nga DPA për disa aktivitete të vlerësimit të konformitetit, vetëm në mediat e komunikimit OVK mund të vendosë simbolin e akreditimit të kombinuar. Simboli i akreditimit i kombinuar përbehet nga logo e DPA-së dhe të gjithë veprimtaritëe vlerësimit të konformitetit, standardet dhe numrat e akreditimit sipas kërkesave të këtij dokumenti. Vlerësimet e konformitetit, standardet dhe numri i akreditimit renditen në rend kronologjik sipas afatit kohor të marrjes së tyre. Kur data e marrjes së akreditimit është e njëjtë, vlerësimet e konformitetit renditen sipas rendit alfabetik. Simboli i kombinuar i akreditimit ose referenca në akreditim si tekst njëkohësisht për dy ose më shumë veprimtari të vlerësimit të konformitetit të akredituara nuk mund të përdoren në raportet/certifikatat e lëshuara nga OVK e akredituara nga DPA.

Referenca në akreditim si tekst zbatohet në të njëjtat kushte si simboli i akreditimit siç përshkruhet në këtë dokument.

OVK e akredituara nuk duhet të bejnë asnjë deklaratë mashtruese ose të paautorizuar në lidhje me akreditimin e tyre.

OVK e akredituar mund të bëjë referencë tek akreditimi si tekst sipas formulimit më poshtë:

"OVK-ja e akredituar nga DPA me numër akreditimi XX XXX për aktivitetin e <.....>"

ku aktiviteti mund të jetë:

testim
ekzaminim mjekësor
kalibrim
inspektim
certifikim produkti
certifikim sistemi menaxhimi
certifikim personi
teste zotësie dhe krahasimeve ndërlaboratorike
materiale referuese të certifikuara
verifikim dhe/ose vlefshmërinë
biobankat

Një OVK e akredituar nuk duhet të përdorë markën e çertifikimit në një certifikatë/raport kalibrimi ose testimi duke përfshirë edhe laboratorët mjekësorë. Organet çertifikuese të akredituar duhet të sigurojnë që klientët e tyre të mos përdorin markën e çertifikimit në një certifikatë kalibrimi/raport testimi. Në rastin e organeve të certifikimit të sistemit të menaxhimit, organet e akredituara duhet të sigurojnë që marka e çertifikimit të mos shfaqet në produkte.

Një organ i akredituar nga DPA nuk duhet të ofrojë certifikim sipas asnjë standardi të përdorur si bazë për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit (p.sh. ISO /IEC 17025, ISO 15189). DPA fillon procedurën e pezullimin të akreditimit të këtij organi i cili siguron çertifikime të tilla.

Një OVK e akredituar nga DPA nuk mund t'i referohet standardit të akreditimit në certifikatat e akredituara të lëshuara prej tij. Një çertifikim i akredituar lëshohet vetëm kundrejt dokumenteve / standardeve që përmbajnë kërkesat e skemës së certifikimit.

Në raportet/certifikatat e lëshuara nga organet e akredituara nga DPA dhe që përfshijnë simbolin e akreditimit është e ndaluar përdorimi i markave/logove të tjera përvec atyre të OVK –së të akredituar (psh. Logo që i përkasin partnerëve, grupeve dhe rrjeteve të ndryshme, shoqatave shkencore, degëve të biznesit). Kjo bëhet me qëllim që të mos kompromentohet qartësia në lidhje me atë se kush është mbajtësi i akreditimit dhe cili është programi i akreditimit.

8. Pezullimi, reduktimi, tërheqja e akreditimit

OVK-të e akredituara mund të përdorin simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst vetëm gjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit të tyre dhe për programin e akreditimit për të cilin janë akredituar sic përshkruhet në pikën 7 të këtij dokumenti.

Në rast se DPA pezullon ose tërheq plotësisht akreditimin, OVK duhet menjëherë të ndalojë përdorimin e simbolit të akreditimit, referencën tek akreditimi si tekst dhe përdorimin e markës ILAC MRA, markës IAF MLA dhe markës EA MLA si në raporte/certifikata ashtu edhe në materiale promovuese, media dhe faqet e websitit.

Në rast se DPA pezullon ose redukton pjesërisht akreditimin, OVK e akredituar menjëherë duhet të ndaloje përdorimin e simbolit të akreditimit, referencën tek akreditimi si tekst dhe përdorimin e markës ILAC MRA, markës IAF MLA dhe markës EA MLA për programin e akreditimit të pezulluar ose të reduktuar si në raporte/certifikata ashtu edhe në materiale promovuese, media dhe faqet e websitit.

Në rast se vlefshmëria e akreditimit skadon, OVK duhet të ndërpresë menjëherë përdorimin e referencës tek akreditimi (simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst) dhe përdorimin e markave EA MLA, ILAC MRA dhe IAF MLA. Në të tilla raste, OVK merr masa të menjëhershme edhe për largimin e cdo materiali promovues, media komunikimi ose faqe webi me referencën tek akreditimi (simboli i akreditimit ose referenca si tekst).

Përdorimi i simbolit të akreditimit ose referenca tek akreditimi si tekst nga OVK jo të akredituar trajtohet në përputhje me ligjin nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Përdorimi i simbolit të akreditimit, referenca tek akreditimi si tekst, referenca tek statusi i DPA dhe tek marka EA MLA, dhe përdorimi i kombinuar i markave ILAC MRA dhe IAF MLA së bashku me simbolin e akreditimit nga OVK të akredituar dhe rregullat e tjera të vendosura në këtë dokument do të vlerësohen rregullisht gjatë vizitave mbikëqyrëse/rivlerësuese/zgjeruese dhe vizitat jashtërradhe. Cdo përdorim në kundështim me kërkesat e këtij dokumenti trajtohet në përputhje me procedurën DA-PM-004.Në rast reduktimi apo tërheqje të akreditimit, DPA njeh certifikatat/raportet e lëshuara nga organet e vlerësimit të konformitetit përpara vendimit të reduktimit apo tërheqjes për një periudhë 3 mujore nga data e marrjes së vendimit për reduktimin apo tërheqjen e akreditimit. Në rast pezullimi të pjesshëm apo të plotë, DPA njeh certifikatat/raportet e lëshuara nga organet e vlerësimit të konformitetit përpara vendimit të pezullimit për aq kohë sa është i vlefshëm pezullimi.

9. Rregullat për referencën tek statusi i DPA në MLA nga OVK- të e akredituara

9.1.1 **Përdorimi i statusit të nënshkruesit të EA MLA nga OVK-të e akredituara.**

DPA është nënshkruese e marrëveshjeve shumëpalëshe të Bashkëpunimit Evropian për Akreditimin (EA) për testimin (ISO/IEC 17025), inspektimin (ISO/IEC 17020), çertifikimin e personave (ISO/IEC 17024) dhe çertifikimin e sistemeve të menaxhimit (ISO/IEC 17021-1).

OVK-të e akredituara nga DPA mund t'i referohen statusit të nënshkruesit të EA MLA të DPA-së ose të përdorin markën EA MLA vetëm nëse programi i akreditimit të tyre përfshihet në fushat për të cilat DPA është nënshkruese e EA-MLA. Marka EA MLA mund të përdoret vetëm nga OVK-të e akredituara nga DPA që janë të vendosura në shtetet ku është e rregjistruar edhe marka EA MLA. Sekretariati i EA publikon dhe përditëson listën e shteteve ku marka EA MLA është e rregjistruar.

OVK-të e akredituara që dëshirojnë të përdorin markën EA MLA duhet të bëjnë një kërkesë me shkrim në DPA dhe mund të fillojnë ta përdorin vetëm pas marrjes së miratimit nga DPA dhe marrjes së markës nga ana e DPA. E drejta e përdorimit të markës EA MLA nuk është e transferueshme.

OVK-të e akredituara e përdorin markën EA MLA vetëm në kombinim me simbolin e akreditimit. Në asnjë rrethanë nuk është i lejuar përdorimi i markës EA MLA i pakombinuar nga simboli i akreditimit. Marka EA MLA përdoret vetëm në dokumentat ku përdoret simboli i akreditimit dhe gjithmonë duke respektuar kërkesat e kësaj politike në lidhje me përdorimin e simbolit të akreditimit. Përdorimi i simbolit të akreditimit në kombinim me markën EA MLA nuk duhet të këtë përmasa më të mëdha se logo e OVK dhe nuk duhet të krijojë konfuzion tek klientët e OVK se cili është lëshuesi i dokumentit ose vërtetimit. Përdorimi i simbolit të akreditimit në kombinim me markën EA MLA nuk duhet të krijojë konfuzion në treg në lidhje me programin e akreditimit të OVK dhe që ky program përfshihet në fushën e EA MLA të DPA-së.

Marka EA MLA mund të përdoret në kombinim edhe me simbolin e kombinuar, sipas kushteve ku mund të vendoset simboli i akreditimit i kombinuar, vetëm nëse OVK është e akredituar nga DPA për dy ose më shumë aktivitete të vlerësimit të konformitetit dhe DPA është anëtare firmosëse e EA MLA për këto aktivitete.

Në rast se OVK e akredituar përdor simbolin e akreditimit në raporte/certifikata, ai mund t'i referohet statusit të nënshkruesit të EA MLA të DPA, së bashku me përdorimin e simbolit të akreditimit, sipas deklaratës së marrëveshjeve shumëpalëshe të mëposhtme:

"DPA është nënshkruese e EA MLA në fushën e [aktivitetit]", ku [aktivitet] do të thotë "testim, inspektim, çertifikim i personave dhe / ose çertifikim i sistemeve të menaxhimit" fusha në të cilat DPA është nënshkruese e EA MLA. Kjo deklaratë vendoset në fund të raportit/certifikatës në përputhje me kërkesat për referencën në akreditim si tekst.

Në rast se OVK e akredituar përdor referencën në akreditim si tekst, ajo mund të përdorë formulimin e mëposhtëm: :

"OVK akredituar nga DPA nën numrin e akreditimit XX XXX për [aktivitet] të mbuluar nga EA MLA " ku [aktivitet] do të thotë "testim, inspektim dhe / ose certifikim i sistemeve të menaxhimit" në të cilat DPA është nënshkruese e EA MLA dhe OVK është akredituar.

OVK-të e akredituara mund të përdorin markën EA MLA, deklaratën e marrëveshjeve shumëpalëshe ose referencën tek akreditimi si tekst sipas formulimeve të sipërpërmendura për statusin nënshkrues të EA MLA të DPA-së mbi raportet dhe çertifikatat nën aktivitetet e nënshkruara të EA MLA.

Klientët e OVK-ve të akredituara nuk mund t'i referohen statusit nënshkrues të EA MLA të DPA-së apo të përdorin markën EA MLA.

DPA pranon aktivitetet e vlerësimit të konformitetit të siguruara nga OVK të akredituara në përputhje me dispozitat e ligjit 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

OVK e akredituara ndërpresin menjëherë përdorimin e markës EA MLA apo referencës tek statusi i DPA në EA MLA në rast se statusi i DPA në EA MLA pezullohet apo tërhiqet.

9.1.2 Rregullat për përdorimin e markës EA MLA

Marka EA MLA si kur përdoret nga DPA ashtu edhe nga OVK e akredituara nga DPA duhet që:

A. Të përdoret në përmasat e saj origjinale, të projektuara, të pa rrotulluara, të shtrembëruara, të ngjeshura ose të shtrira në asnjë mënyrë;
B. Të mos shfaqen në një madhësi ose me një sfond që i bën fjalët të palexueshme;
C. Të mos riprodhohen me një gjerësi nën 15 mm.
D. Të mos jenë të fshehura ose të mbivendosura plotësisht ose pjesërisht nga ndonjë imazh, tekst ose imazh grafik tjetër;
E. Të riprodhohen duke përdorur skedarin grafik origjinal të Markës EA MLA të dhënë nga Sekretariati EA.

Marka EA MLA do të përdoret gjithmonë në të majtë të logos apo simbolit të akreditimit dhe në afërsi 5 mm nga njëra- tjetra. Shkronjat brenda markës nuk mund të ndryshohen. Marka mund të riprodhohet bardh e zi nëse edhe logo e DPA ose simboli i akreditimit është bardhë e zi. Ngjyrat origjinale të markës EA MLA janë:

	CMJN	Pantone	RGB	HTML	Black
Blu	C90% M50% Y0% B10%	2935C	R 0% G102 B169	#0066a9	B 100%
E verdhë	C0% M35% Y100% B0%	130C	R249 G179 B0	#0066a9	B 100%

Nuk lejohet fotokopjimi i logove dhe markave nga dokumenta të tjera. DPA dhe OVK e akredituara prej saj janë të detyruar të zbatojnë rregullat e vendosura në dokumentin EA 3/01 S1 ne lidhje me përdorimin e markës EA MLA.

9.2 Rregullat për përdorimin e markave ILAC MRA ose the IAF MLA në kombinim me simbolin e akreditimit.

Gjatë statusit nënshkrues të DPA-së në ILAC MRA në fushat e testimit dhe inspektimit, dhe në IAF MLA në fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit (ISO 22000, ISO 9001, ISO 14001, ISO 27001, ISO 13485, ISO 50001,ISO 45001 dhe ISO 37001), OVK-të e akredituara nga DPA në këto fusha mund të përdorin respektivisht markën ILAC MRA ose markën IAF MLA në kombinim me simbolin e akreditimit (marka e kombinuar) gjatë vlefshmërisë së akreditimit të tyre.

Të njëjtat rregulla dhe kushte duhet të aplikohen për përdorimin e markës së kombinuar si për simbolin e akreditimit.

Si një kërkesë shtesë, OVK e akredituar është e detyruar të nënshkruajë një marrëveshje të licencës me DPA për përdorimin e kombinuar të markës ILAC MRA (shih shtojcën 1 të kesaj politike) ose përdorimin e kombinuar të markës IAF MLA (shih shtojcën 2 të kesaj politike). Përpara se të nënshkruajë marrëveshjen, OVK është e detyruar të depozitojë në DPA një shembull të markës së kombinuar në mënyrë që DPA të verifikojë mënyrën e dukjes së saj përpara dhënies së miratimit për përdorim të markës së kombinuar.

Kur OVK ka akreditim në disa fusha të ILAC MRA, p.sh: testim dhe inspektim, një marrëveshje e veçantë e licencës do të lidhet përkatësisht për çdo akreditim. OVK e akredituar i bashkëngjit kërkesës drejtuar DPA-së një marrëveshje të plotësuar dhe të nënshkruar të licencës në 2 kopje dhe një mostër të përdorimit të kombinimeve të markës ILAC MRA ose markës IAF MLA. DPA dërgon një kopje të nënshkruar të marrëveshjes së licencës tek OVK e akredituar. Data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së licencës është data e nënshkrimit nga DPA. Rregullat e hollësishme të përdorimit të kombinuar të markës së ILAC MRA ose markës IAF MLA janë të përcaktuara në marrëveshjen përkatëse të licencës. Licenca e nënshkruar nga DPA nuk mund të transferohet tek organet ose personat e tjerë.

Në kombinim e markave, madhësia e markës së MRA të ILAC ose markës MLA të IAF duhet të jetë në përpjesëtim me madhësinë e simbolit të akreditimit.

Laboratorët testues dhe organet inspektuese kur përdorin markën e kombinuar ILAC MRA dhe simbolin e akreditimit, mund të vendosin në raportin/certifikatën e testimit ose inspektimit deklaratën: DPA është anëtare nënshkruese e ILAC MRA për <aktivitetin>, ku aktiviteti është testim ose inspektim. Kjo deklaratë vendoset në fund të faqes së raportit/certifikatës dhe vendoset vetëm njëherë. Lloji i shkrimit dhe madhësia duhet të jenë të njëjta me llojin dhe madhësinë e shkrimit të përmbajtjes së raportit/certifikatës.

Organet certifikuese të sistemit të menaxhimit, kur përdorin markën e kombinuar IAF MLA dhe simbolin e akreditimit, mund të vendosin në raportin/certifikatën e certifikimit deklaratën: DPA është anëtare nënshkruese e IAF MLA për <aktivitetin>, ku aktiviteti është certifikim sistemi menaxhimi. Kjo deklaratë vendoset në fund të faqes së raportit/certifikatës dhe vendoset vetëm njëherë. Lloji i shkrimit dhe madhësia duhet të jenë të njëjta me llojin dhe madhësinë e shkrimit të përmbajtjes së raportit/certifikatës. Referenca tek marka e kombinuar dhe si rrjedhim edhe përdorimi i deklaratës është e kufizuar vetëm për skemat ISO 22000, ISO 9001, ISO 14001, ISO 27001, ISO 13485, ISO 50001, ISO 45001 dhe ISO 37001.

9.2.1 Marka e ILAC MRA në kombinim me simbolin e akreditimit:

Marka e ILAC MRA do të përmbajë:

Marka ILAC MRA + Simbolin e akreditimit

Kodi i ngjyrave të markës ILAC MRA është Blue – e errët 293C.

9.2.2 **Marka e MLA IAF në kombinim me simbolin e akreditimit**

Marka e IAF MLA do të përmbajë:

Marka IAF MLA + Simbolin e akreditimit

Ngjyra e markës IAF MLA është blu e errët - 2747 dhe blu e lehtë – 299.

Në kombinim e markave, madhësia e markës së MRA të ILAC ose markës MLA të IAF duhet të jetë në përpjesëtim me madhësinë e simbolit të akreditimit.

10. Paraqitja e simboleve te akreditimit

Testim S SH EN ISO/IEC 17025 LT XXX	Kalibrim S SH EN ISO/IEC 17025 LK XXX	Testim S SH EN ISO 15189 LM XXX

Inspektim
S SH EN ISO/IEC 17020
TI XXX

Verifikim
S SH EN ISO/IEC 17029
VV XXX

Biobanka
S SH EN ISO 20387
BI XXX

Certifikim personi
S SH EN ISO/IEC 17024
CN XXX

Certifikim sistemi menaxhimi
S SH EN ISO/IEC 17021-1
CS XXX

Certifikim produkti
S SH EN ISO/IEC 17065
CP XXX

Ku: XXX është numri rendor i certifikatës së akreditimit që varion nga 001 deri ne 999 per cdo aktivitet të vlerësimit të konformitetit.

Paraqitja e simbolit të kombinuar është si më poshtë:

Testim
S SH EN ISO/IEC 17025
LT XXX
Kalibrim
S SH EN ISO/IEC 17025
LK XXX

Paraqitja e simbolit të akreditimit me markat e IAF MLA dhe ILAC MRA është si më poshtë:

Certifikim sistemi menaxhimi
S SH EN ISO/IEC 17021-1
SC XXX

Testim
S SH EN ISO/IEC 17025
LT XXX

Paraqitja e simbolit të akreditimit me markën EA MLA është si më poshtë:

Testim
S SH EN ISO/IEC 17025
LT XXX,

Drejtori i Përgjithshëm

Pranvera Fagu

Date: 17.10.2025

Data efektive per zbatimin e pikës 6 të kësaj politike për pozicionin e logos së OVK: 14.05.2026.

Data efektive për zbatimin e pikës 6 dhe 10 për paraqitjen e simbolit të akreditimit: 17.10.2026